

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË  
“MEI UNION” Sh.P.K.**

*Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

*Sot më 27.06.2022, unë, Z. Everest Piroli shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Zhejë, Kurbin, i datelindjes dt.21.11.1988, mbajtës i kartës së identitetit me Iden.nr. 181121056C madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “për shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zhatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoj këtë Statut si vijon:*

*Në këtë Statut:*

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 ‘Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’ i ndryshuar
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë

**KREU I**

*Themeli, Emri, Objekti, Kohëzgjatja*

*Neni 1*

*Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit, Selia*

*Sot, më 27.06.2022, themeluesi i mësipërm, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar “MEI UNION” SH.P.K.*



*Neni 2*

*Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Agjensi shërbime komisionere. Veprimitari e agjentit komisionere. Veprimitari e agjentit per transferta parash në emër dhe për llogari të një subjekti finanziar jo bankë. Këmbim valute. Veprimitari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretë në emër dhe për llogari të një subjekti jo bankë dhe shërbime Unionet - Western Union.*

*Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zoterojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.*

*Neni 3*

*Kohëzgjatja*

*Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.*

*Neni 4*

*Selia*

*Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Mamurras, Lagjja "Zef Hoti", Rruga Kryesore, Ndertesë5 katëshe, Kati 1. ZK. Nr 2586. Me Pasuri nr. 2/I21-N2.*



*Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfuqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.*

*Kreu II*

*Kapitali*

*Neni 5*

*Kapitali themeltar*

*Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 2.500.000 (dymilionëpesëqindmije) lekë dhe zotërohet tërësisht nga ortaku themelues Z:Everest Piroli zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2.500.000 (dymilionëpesëqindmije) lek, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

*Kontributi i ortakut është në para.*

*Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.*

*Neni 6*

*Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit*

*Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë,*



*nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribuite sipas kërkesës së administratorit.*

*Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.*

*Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njejtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.*

### *Neni 7*

#### *Transferimi i kapitalit*

*Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:*

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Çdo mënyrë tjeter e parashikuar me ligj.

*Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.*

*Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.*



*Kreu III*

*Organet vendimmarrëse dhe drejtuese*

*Neni 8*

*Organi vendimmarrës*

*Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.*

*Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.*

*Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:*

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve
- d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- e. Përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Shpërndarjen e fitimeve vjetore
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

*Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.*



*Autorizimi mund tē jepet vetēm pēr një mbledhje tē asamblesë sē pērgjithshme, e cila pērfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njejin rend dite.*

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes sē mbledhjes sē Asamblesë sē Përgjithshme**

*Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet tē përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet tē gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar pēr mbledhjen e asamblesë.*

*Kur asambleja e përgjithshme nuk është ëthirrur sipas pikës 1 tē këtij nenit, ajo mund tē marrë vendime tē vlefshme vetëm nëse tē gjithë ortakët janë dakort pēr tē marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.*

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

*Në rastin e marrjes sē vendimeve që kërkojnë një shumicë tē zakonshme, asambleja e përgjithsme mund tē marrë vendime tē vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me tē drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% tē kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet tē vendosë pēr çështje, tē cilat kërkojnë shumicë tē kualifikuar sipas nenit 87 tē ligjit “Pēr tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund tē marrë vendime tē vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total tē votave, janë tē pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo njete elektronike, sipas parashikimeve tē pikës 3 tē nenit 88 tē këtij ligji.*



*Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njejin rend dite.*

### *Neni 11*

#### *Marrja e vendimeve*

*Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruar të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë; emerimin e administratorëve; emerimin e shkarkimin e likuiduesve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; mitarimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.*

### *Neni 12*

#### *Përjashtimi nga e drejta e votës*

*Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonje detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jot ë përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqsohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njejin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.*



### *Neni 13*

*Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëriturje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Komëtare të Biznesit.*

*Personat e mëposhtëm caktohen si administrator të parë të shoqërisë për një mandate të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:*

- Z.Everest Piroli shtetas shqiptar, lindur më 21.11.1988 lindur dhe banues në Zhejë Kurbin, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal 181121056C madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pakufizime në kompetencat e administrimit.*

### *Kreu IV*

*Viti finanziar – eksperët*

### *Neni 14*

*Viti finanziar*

*Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllte me 31 dhjetor.*



### *Neni 15*

#### *Ekspertët*

*Eksperi ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit, eksperi kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtua e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.*

### *Kreu 5*

#### *Prishja – riorganizimi i shoqërisë*

### *Neni 16*

#### *Prishja dhe likujdimi*

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likujdim e sipër”. Prishja e shoqëris tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.*

*Likujdimi kryhet nga likujduesit që janë emëruar nga Ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.*

*Neni 17*

*Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja*

*Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtar*

*Neni 18*

*Baza ligjore*

*Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kodit Civil dhe qfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.*



*Neni 19*

*Mosmarrëveshjet*

*Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.*

*Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:*

**ORTAKU THEMELUES**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"MEI UNION " Shpk**

**Z. EVEREST PIROLI**

